



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d**, të Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 24.4.2024, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR DY FAMILJE STREHUESE**  
**SINANI DHE SELMANI**

1. MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për dy familje strehuese, të cilat përkujdesen për dy fëmijë (tashmë të moshës madhore) me aftësi të kufizuara, pa përkujdesje prindërore dhe familjare.
2. Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës 1 të këtij vendimi, është 10.000.00 € (dhjetë mijë euro), nga 5,000.00 € (pesë mijë euro) për secilën familje për një vit, shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve në Drejtorinë e Mirëqenies Sociale.
3. Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve për dy familje strehuese, familjet Sinani dhe Selmani, të cilat përkujdesen për dy fëmijë (tashmë të moshës madhore) me aftësi të kufizuara, pa përkujdesje prindërore dhe familjare.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Kryeqytetit, Drejtoria e Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Financave.
5. Pjesë e këtij Vendimi është Konstatimi zyrtar.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-450/03-54428/24, më 26.4.2024

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Fehmi Kupisra



## Arsy et im

Drejtoria e Mirëqenies Sociale, përmes Qendrës për Punë Sociale, sipas kompetencës dhe detyrës zyrtare aplikon formën e mbrojtjes juridike dhe sociale për fëmijët pa kujdes prindëror, në përputhje me dispozitat e Ligjit të Familjes 2004/32, për vendosjen në kujdestari dhe Ligjit për shërbime sociale dhe familjare, si dhe Udhëzimit administrativ nr. 02/2016 për rregullimin e strehimit familjar në Kosovë. Strehimi familjar është formë alternative e kujdesit familjar.

Qendra për Punë Sociale në Prishtinë, në cilësi të Organit të kujdestarisë, duke vendosur lidhur me strehimin familjar të fëmijës pa kujdes prindëror, në bazë të nenit 204, pika 1 dhe pika 2 të Ligjit për familjen i Kosovës, nr. 2004/32, nenit 3, pika 1.9 dhe pika 1.11, nenit 6, pika 1 dhe pika 8 e Udhëzimit administrativ (MPMS) nr. 02/2016, për rregullimin e strehimit familjar në Kosovë, nxjerr Aktvendim për vendosjen e fëmijës pa kujdes prindor. Po ashtu, duke u bazuar në nenin 205 dhe nenin 208 të Ligjit nr.2004/32, të LFK-së dhe duke u bazuar në nenin 6, pika 8, nenin 13, pika 1 dhe pika 2 të Udhëzimit administrativ (MPMS) nr. 02.2016, për rregullimin e strehimit familjar në Kosovë, si dhe nenit 8, pika 2 të Udhëzimit administrativ (MPMS), nr. 08/2017, për plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimit administrativ (MPMS) nr. 02/2016, për rregullimin e strehimit familjar në Kosovë, lidh kontratë me prindin strehues, përmes së cilës specifikohen detyrimet e palëve për plotësimin e nevojave të fëmijës në strehim (Kontrata për strehim familjar).

Qendra për Punë Sociale në Prishtinë momentalisht i ka dy raste të fëmijëve të braktisur me aftësi të kufizuara, të cilët janë të vendosur në strehim familjar jashtë familjes. Ky shërbim deri në moshën 18 vjeçe kompensohet nga Ministria përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale, në vlerë prej 350 euro në muaj, mirëpo me kalimin e moshës, Ministria e ndërpret pagesën. Meqenëse ne si Komunë nuk kemi asnjë zgjidhje tjetër, si dhe në Institutin e Shtimes nuk ka vende të lira, ne jemi të obliguar që të kërkojmë nga familja strehuese që të vazhdojnë me kujdesin ndaj fëmijëve, duke kompensuar ne si Komunë këtë shumë financiare, e cila dedikohet për plotësimin e nevojave të fëmijëve (për shërbime të strehimit, kujdesit, ushqimit, veshmbathjeve, higjienës, edukimit, përkrahjes psiko-sociale etj.).

Drejtoria e Mirëqenies Sociale propozon që të miratohet një shumë prej 10,000.00 € (dhjetë mijë euro), nga 5,000.00 € (pesë mijë euro) për secilën familje për një vit, në mënyrë që të përkrahen këto familje rreth kujdesit të fëmijëve të braktisur me aftësi të kufizuara pa përkujdesje prindërore dhe familjare.